




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 730/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Goran Milenković – Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik“Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE:N.N.T. “EING COM” & N.T.SH. “EKOINVEST”- Dumosh Podujeve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull të prokurimit:“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese ne qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan më datën:17.01.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese ne qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese ne qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan dhe lënda kthehet ne **Ri - vlerësim**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:02.07.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:10.08.2018

Njoftimi me letrën standarde për tenderues të eliminuar është bërë dt: 27.11.2018

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik:“Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues me dt:30.11.2018.

Me dt: 04.12.2018,Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik:“Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.12.2018 me nr. 730/18,kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve sinjalizuese ne qytetin e Lipjanit”, me numër të prokurimit: 613-18-4584-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Lipjan duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1.1 Kreu II , 7 Kreu IV, 56, 72të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik- RRUOPP 39.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.12.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit si dhe ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues/teknik në raportin e dt:03.01.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Autoriteti Kontraktues - "Komuna Lipjan", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar Procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: "Sinjal" sh.p.k.- Ferizaj, ka parashtruar ankesë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas rivlerësimit të ofertave, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit ku AK, tekstualisht ka potencuar: "Dokumentet e bashkangjitura të specifikave teknike të aneksit 1, nuk i keni sjellë dëshmitë për këto pajisje po të njëjtin mendim e ka dhënë edhe OSHP, dhe Autorizimet e kompanisë DETAS nuk janë të vulosura në baze të kërkesës së AK, po të njëjtin mendim e ka dhënë edhe OSHP.

- Pretendimet ankimore janë trajtuar në tërësi nga eksperti teknik pasi që i njëjti të gjitha shkresat e lendes deri në datën e protokollimit të këtij raporti.

Fillimisht po sqarojmë se disa nga pretendimet ankimore që lidhen me arsyetimin e eliminimit tanimë janë trajtuar dhe shqyrtuar përmes vendimit të panelit Shqyrtues të datës 26.09.2018, me nr. 458/18, rrjedhimisht ritrajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara nga paneli shqyrtues, paraqet mos respektim të nenit 16, të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017. Pretendimi i parë OE është që OE i propozuar për kontratë nuk ka paraqitur deklaratën mbi specifikimet teknike e që faktikisht kjo certifikatë është në dosjen e tenderit të dorëzuar nga OE "Eing" sh.p.k. dhe Ekoinvest .Ku citoj DEKLARATE Në të poshtë nënshkruarit si përfaqësues të grupit –konsorciumit deklarojmë me përgjegjësi materiale dhe ligjore se jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës që ti kryejmë punët sipas kontratës së mundshme, sikurse edhe të gjitha obligimet tjera që rrjedhin nga kontrata. Ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi i dytë është në atë që OE i propozuar për kontratë ka bashkangjitur në dosjen e tenderit me se 20 projekte por vetëm 3 nga ato kanë qenë me referenca. Ky pretendim është i pa bazuar pasi që edhe pse OE ka dorëzuar me tepër se 20 projekte, kërkesa në dosjen e tenderit thotë që duhet të dorëzohen projekte me referenca që mbulojnë vlerën prej 220.000 euro e që OE i propozuar në kontratë e arrin këtë vlerë me ato 3 referenca në të cilën deklarohej edhe OE ankues, Këtë pretendim e konsideroj si të pa bazuar.

Pretendimi i tretë i OE ka qenë që OE fitues nuk ka paraqitur certifikatë të zinkimit , Certifikata nga OE i propozuar për kontratë e ka paraqitur certifikatën në pjesën e fundit të dosjes së tenderit nr 31 afati i asaj kontrate ka qenë valid deri më 15. 09.2018 data e fundit për dorëzim të dosjes së tenderit ka qenë 10.08.2018, ndërsa ATESTIN që pala ankuese pretendon se është me afat të skaduar ajo nuk ka datë skadence vetëm datën e nënshkrimit, si dhe ka një datë kur tregon që është bërë faturimi (25.07.2018). Sipas mendimit time edhe ky pretendim është i pa bazuar. Sa i përket pretendimit për ISO standardet nga OE ankues, në kriteret e tenderimit dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK konsideroj që janë të pa baza pasi që ISO standardet janë standarde të krijuara nga organizata që merret vetëm me standardizim nuk paraqet MARKE TE CAKTUAR, EMER TE BRENDIT, PATENET, DIZAJN, LLOJI, ORIGJINE, PRODHUES, MONTUES, KATALOG OSE ARTIKULL ME NUMER

Te cilën e arsyetoj edhe me faktin qe LPP i amandamentuar neni 28 pika 7 thotë qe: Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni.

Sa i përket pretendimit përbashkëpunim dhe manipulim me tenderin nga ana e OE te propozuar për kontrate me organizatën DEMOS nuk mund te merret si baze ajo qe këto dy subjekte kanë punuar edhe me herët ne projekte te ndryshme, ashtu siç keni pretenduar edhe te çmimi qe nuk është baze ankimore pasi qe tenderi i shpallur ka qene me vlere 150.000.00 e çmimi i ofruar është ne suaza te tenderimit ne fjale.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon i panelit shqyrtues te OSHP-së, qe te mbetet ne fuqi vendimi i autoritetit kontraktues pasi qe te gjitha pretendimet ankimore te OE ankues ne këtë rast SINJAL SHPK i konsideroj si te pa baza.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.01.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 04.01.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.01.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Ramadani deklaroi: Konsideroj se raporti i ekspertit është i devijuar dhe nuk i trajton ne tersi preokupimet tona te shprehura ne ankesën e dorëzuar pran OSHP-se, për arsye te mëposhtme: AK na ka eliminuar si njëra nder 2 arsytet për shkak se autorizimi ynë nuk ka qen origjinal por i skanuar dhe i vulosur, autorizimi ynë është me vulë elektronike por është i skanuar, mirëpo AK nuk ka marr parasysh RRUOPP-në nenin 39 pika 39.8 thotë se AK duhet te dërgoj kërkesë për sqarim te tenderit tek OE përmes sistemit te prokurimit ose ne formë fizike dhe OE duhet te dorëzojnë përgjigjet tek AK. Konkretisht është kërkuar autorizimi origjinal dhe është dorëzuar autorizimi i skanuar sipas rregullores mund te kërkohe

informata sqaruese ku ne asnjë here nuk kemi marr informata sqaruese. Arsyeja tjetër e eliminimit sipas AK-se, qe është e paqarte se çfarë kanë kërkuar citoj: Dokumentet e bashkangjitura te specifikacionit te aneksit 1 nuk keni sjellë dëshmi për këto pajisje ne e kemi dorëzuar deklaratën me specifikacionet teknike ku i kemi dorëzuar edhe raportet teknike qe janë kërkuar për specifikacione teknike, vlen te theksohet se OE-së i propozuar për kontratë, pas qasjes ne dokumente nuk i kemi hasur ne deklaratën për specifikacione teknike e nëse bazohemi ne rregulloren ku thuhet nëse mungon deklarata mbi specifikacionet teknike duhet te refuzuar tenderin pa kërkuar informacione te mëtejshëm. Një pike tjetër te ankesës sonë qe eksperti nuk e ka shqyrtuar fare, tek dokumentet mbi kapacitetin teknik dhe financiar OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një dokument nga banka NLB te pavulosur qe kemi dëshmi për panelin qe dihet qe asnjë bankë nuk ofron dokument pa vule dhe e konsiderojmë standard te dyfishtë pasi te ne për arsye te eliminimit e kanë përmendur një vule. Gjithashtu rreth pikës sonë te ankesës se OE i rekomanduar një atesti nga viti 2016 eksperti shqyrtues na hedh poshtë këtë pretendim se dëshmia është nga viti 2018 gjithashtu kjo nuk është ndonjë certifikate e zinkimit qe ky OE ka ndonjë marrëveshje për zinkim. Gjithashtu Eksperti ne raportin e tij ka përmendur se jemi eliminuar për ISO standarde, ne kemi cekur se ne specifikacionet teknike janë futur disa raporte me shifra EN e qe janë krejtësisht ndryshe nga ajo qe ka shqyrtuar eksperti dhe kemi cekur se ato raporte kanë qen diskriminuese dhe për fund i propozojmë panelit shqyrtues qe lënda te kthehet ne rishqyrtim sepse AK kur na ka eliminuar për origjinalitetin e autorizimit ka vepruar ne kundërshtim me LPP-në, konkretisht nenin 72 si dhe RRUOPP-së neni 39 pika 39.8 gjithashtu për arsye se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dokument origjinal te vulosur.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-z.Sadiku deklaroi: Ne si Autoritet kontraktues pajtohemi me mendimin e eksperteve te cilët ia kanë hedhur te gjitha pretendimet te palës ankuese si te pabazuara ne edhe me tutje qëndrojmë prapa vendimit te marr nga Autoritet kontraktues dhe i propozojmë Panelit Shqyrtues qe të mbetet ne fuqi vendimi ynë.

Përfaqësuesi i OE-së, se rekomanduar për kontrate z. Podvorica deklaroi: Unë veç desha te shtoj se kjo lënde është për here te 3-të dhe OE ankues ne bazë te vendimit PSH.458/18, është shpallur i papërgjegjshëm kundër pretendimit ankimore ka qene edhe mos plotësimi i karakteristikave teknike te ofruara nga OE tani ankues duke ofruar katalogë autorizime te një prodhuesi Kinez e qe dihet qe produktet e Kinës janë thuaj se 50 % me te lira se këto te Evropës.

Gjatë prezantimit në seance Eksperti shqyrtues z. Bibaj deklaroi: Sqaroj se paneli shqyrtues për këtë AP ka nxjerr vendimin PSH.458/18 të datës 26.09.2018, ku objekt shqyrtimi ka qene edhe oferta e parashtruesit tani ankesës dhe OSHP ofertën e te njëjtit e ka trajtuar si ofertë te papërgjegjshme kryesisht me lidhje teknike.

Pretendimet tani ankimore te njëjtit ne tërësi janë trajtuar nga eksperti teknik qe kryesisht ka te beje me anulimin e ofertës se tyre vazhdon eksperti teknik.

Gjatë prezantimit në seance eksperti teknik z. Bojaj deklaroi: Pika e pare e pretendimit Operatorit ekonomik ankues thuhet se nuk ka paraqitur deklaratë mbi specifikacionin teknike e ku kjo deklarate është ne dosjen e tenderit te dorëzuar nga Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ku citoj ne te poshtë shënuarit dhe nënshkruarit si përfaqësues te grupit konsorciumit deklarojmë me përgjegjësi materiale dhe ligjore se jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës qe ti kryejmë punët sipas kontratës se mundshme sikur se edhe te gjitha obligimet tjera qe rrjedhin nga kontrata. Pretendimi i dyte i Operatorit ekonomik ankues është ne atë qe Operatori ekonomik i rekomanduar ne dosjen e tenderit ka bashkangjitur mese 20 projekte por vetëm 3 nga ato kanë qene me referenca e qe Operatori ekonomik ka dorëzuar 20 projekte, por ato 3 projekte qe janë te dorëzuara me referenca i mbulojnë kriteret e tenderit sa i përket pretendimit për ISO standardet Operatori ekonomik ankues i ka përmendur këto standarde qe janë futur ne kriteret e tenderit si qeshte standardi ISO 9001 e qe këto standarde nuk bien ndesh me LPP-në pasi qe janë standarde te cilat nuk paraqesin ndonjë markë te caktuar emër tëbrenditë, dizajn e etj. por janë standarde te cilat kërkohen për pune sa me kualitative dhe cilësore. qëndrojmë prapa raportit ton.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi, gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se operatori ekonomik ankues: “Sinjal” sh.p.k.- Ferizaj, ka parashtruar ankesë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas rivlerësimit të ofertave, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit ku AK, tekstualisht ka potencuar: “Dokumentet e bashkangjitura te specifikave teknike te aneksit 1, nuk i keni sjellë dëshmitë për këto pajisje po te njëjtin mendim e ka dhënë edhe OSHP, dhe Autorizimet e kompanisë DETAS nuk janë te vulosura ne baze të kërkesës se AK, po te njëjtin mendim e ka dhënë edhe OSHP.

- Pretendimet ankimore janë trajtuar në tërësi nga eksperti teknik pasi qe i njëjti te gjitha shkresat e lendes deri ne datën e protokollimit te këtij raporti.

Fillimisht po sqarojmë se disa nga pretendimet ankimore e që lidhen me arsyetimin e eliminimit tanimë janë trajtuar dhe shqyrtuar përmes vendimit të panelit Shqyrtues të datës 26.09.2018, me nr. 458/18, rrjedhimisht ritrajtimi i pretendimeve ankimore të gjykuara nga paneli shqyrtues, paraqet mos respektim të nenit 16, të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017. Pretendimi i pare OE është qe OE i propozuar për kontratë nuk ka paraqitur deklaratën mbi specifikimet teknike Paneli shqyrtues konstaton se është i qëndrueshëm ky pretendim.

Lidhur me pretendimin se OE i propozuar për kontratë ka bashkangjitur ne dosjen e tenderit me se 20 projekte por vetëm 3 nga ato kanë qene me referenca. Paneli shqyrtues Obligon AK-ne që gjate rivlerësimit duhet te sqaroj sakte konform nenit 59 dhe 72 se OE i rekomanduar per kontrate i plotëson kërkesat e AK-se te vendosura ne njoftimin per kontrate dhe FDT.

Lidhur me pretendimin se OE fitues nuk ka paraqitur certifikatë te zinkimit , sipas sqarimeve te ekspertit teknik, OE i propozuar për kontrate e ka paraqitur certifikatën ne pjesën e fundit te dosjes se tenderit nr 31 afati i asaj kontrate ka qene valid deri me 15. 09.2018 data e fundit për dorëzim te dosjes se tenderit ka qen ka qen 10.08.2018, ndërsa ATESTIN qe pala ankuese pretendon se është me afat te skaduar ajo nuk ka date skadence vetëm datën e nënshkrimit, si dhe ka një date kur tregon qe është bere faturimi (25.07.2018).Paneli shqyrtues Obligon AK-ne që gjate rivlerësimit duhet te sqaroj sakte konform nenit 59 dhe 72 se OE i rekomanduar per kontrate i plotëson kërkesat e AK-se te vendosura ne njoftimin për kontrate dhe FDT.

Sa i përket pretendimit për ISO standardet nga OE ankues, ne kriteret e tenderimit dhe specifikimet teknike te kërkuara nga AK Paneli shqyrtues sqaron se, eksperti teknik konsideron qe janë te pa baza pasi qe ISO standardet janë standarde te krijuara nga organizata qe merret vetëm me standardizim nuk paraqet MARKE TE CAKTUAR, EMER TE BRENDIT, PATENET, DIZAJN, LLOJI, ORIGJINE, PRODHUES, MONTUES, KATALOG OSE ARTIKULL ME NUMER,Paneli shqyrtues Obligon AK-ne që gjate rivlerësimit duhet te sqaroj sakte konform nenit 59 dhe 72 se OE i rekomanduar per kontrate i plotëson kërkesat e AK-se te vendosura ne njoftimin per kontrate dhe FDT.

Paneli shqyrtues sqaron se nëse ka një ankese ne OSHP lidhur me një aktivitet atëherë AK nuk duhet patjetër qe gjate rivlerësimit ta shpërblejnë me kontrate atë OE, vetëm se pretendimet e tij janë aprovuar si te bazuara apo pjesërisht te bazuara nga paneli shqyrtues i OSHP-se, pasi qe ato pretendime kane mund te jene te gjitha për tjetër OE dhe Paneli nuk e ka konstatuar për OE-ne qe ja ka aprovuar pretendimet se i plotëson te gjitha kërkesat e AK-se, dhe gjate rivlerësimit AK ta shpërblej me kontrate, por AK-te janë te obliguara konform te gjitha dispozitave te LPP-se dhe rregulloreve te KRPP-se ta rivlerësojnë ate aktivitet te prokurimit dhe ta rekomandojnë vetëm OE-ne qe i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se ne njoftim per kontrate dhe FDT pra AK-te janë te obliguara qe ti respektojnë kërkesat e veta te vendosura ne njoftimin për kontrate dhe FDT. Nëse asnjeri nga OE-te nuk i plotëson kërkesat atëherë aktivitetin e prokurimit duhet ta anuloj konform dispozitave te LPP-se dhe rregulloreve te KRPP-se.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 dhe 60 dhe 72 të LPP-së. Paneli shqyrtues duke u bazuar ne ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit obligon AK-

në, që gjatë rivlerësimit të bënë vlerësim real të ofertave sipas kërkesave të vendosura nga vet AK në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime shtesë nga OE-te. Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu AK duhet vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z.Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –KK- LIPJAN

1x1 OE- “Sinjal” SH.P.K.- Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.